



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

**UDHËZIM**

Nr. 01, Datë 19.09. 2011

**“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR SHPËRBLIMIN PËR MERITA  
PROFESIONALE TË OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “gj” i ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar) dhe neneve 12/a pika 3 të ligjit nr.8677, datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, (i ndryshuar)

**UDHËZOJ :**

1. Drejtuesit e Prokurorive të të gjitha hallkave për të vlerësuar meritat profesionale të oficerëve të Policisë Gjyqësore, duhet të evidentojnë një nga këto kritere;

a) njohuri dhe zotërim të kompetencave të specializuara, jo të zakonshme, në lidhje me teknologjitë speciale dhe disiplinat teknike;

b) prodhimi më të lartë se mesatarja ose angazhim për të punuar jashtë orarit;

c) menaxhim shumë i mirë i çështjeve komplekse, për shkak të numrit, rëndësisë ose ndjeshmërisë së krimeve, numrit të të pandehurve, implikimeve ndërkombëtare, kërkimit të analizave ose vlerësimeve të provave të shumta, situatave emergjente dhe rrezikshmërisë që lidhet me veprimtarinë;

ç) rezultatet e arritura në koordinimin e grupeve të mëdha hetimore dhe bashkëpunimin me grupe të tjera, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

d) cilësinë e akteve procedurale të nxjerra.

2. Vlerësimi vjetor individual i punës sipas nenit 12/c të ligjit nr.8677, datë 02.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, (të ndryshuar), nuk përbën shkak për dhënien e shpërblimit sipas këtij udhëzimi.

3. Drejtuesi i Prokurorisë pasi kryen vlerësimin e meritave profesionale komunikon në mbledhjen e kolektivit, emrin e oficerit të policisë gjyqësore, të cilin mendon t’i propozojë Prokurorit të Përgjithshëm, për shpërblim.

4. Propozimi që i dërgohet për miratim Prokurorit të Përgjithshëm, duhet të përmbajë përshkrimin e shkakut të vlerësimit dhe të shoqërohet me të gjitha dokumentat që shërbejnë për një vlerësim të saktë të meritave të oficerit të Policisë Gjyqësore.

5. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtuesit e të gjitha hallkave të Prokurorisë, Drejtoria Ekonomike dhe e Financës dhe Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

6. Pika 2 e Urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm nr.84 datë 16.01.2010, “Për shpërblimin e prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

  
**INA RAMA**